



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS



# NJOFTIM PËR PYETËSORIN STUDENTOR

I dashur student,

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga “Ligj Nr. 80/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 103, Pika 3, Universiteti Politeknik i Tiranës organizon Pyetësorin Studentor për cilësinë e mësimdhënies në çdo program studimi.

Nëpërmjet këtij pyetësi, çdo student do t’i jepet mundësia të shprehë perceptimin e tij mbi procesin mësimor dhe personelin akademik si dhe të përcjellë pranë autoriteteve të universitetit shqetësime specifike. Ky pyetësor na ndihmon të krijojmë një panoramë të përgjithshme të problematikave në UPT, duke u fokusuar tek shqetësimet e studentëve, për të mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike.

Plotësimi i pyetësit do të jetë i mundur duke filluar prej datës **27 Janar, deri më 05 Shkurt 2020** nëpërmjet platformës online të sekretarisë mësimore.

**Link:** <http://bit-albania.com/upt.php>

Përgjigjet e pyetësit ruhen dhe përpunohen në mënyrë **ANONIME** nga UPT dhe mbi bazën e tyre hartohen të dhëna statistikore për të evidentuar problematikat kryesore të perceptuara nga studentët. Në çdo rast, analiza e të dhënave të pyetësit do të përcillet në fakultete pas përfundimit të sesionit të provimeve, duke shmangur kështu çdo ndikim të mundshëm në vlerësimet përfundimtare.

Plotësimi i pyetësit do të bëhet për çdo pedagog që merr pjesë në procesin e mësimdhënies në semestrin aktual. Në llogarinë tuaj online do të shfaqet pyetësi vetëm për lëndët që frekuentoni si student i rregullt në këtë semestër.

Universiteti Politeknik e vlerëson maksimalisht mendimin tuaj dhe ju nxit të merrni pjesë në këtë proces.

Duke punuar së bashku, UPT mund të vijojë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike duke vazhduar traditën e ekselencës e duke konsoliduar reputacionin kombëtar e rajonal.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin,

**Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë**

**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**

**Shënim:**

- Për problematika në plotësimin e pyetësit apo për pasaktësi në të, jeni i lutur t’i drejtoheni sekretarisë mësimore pranë fakultetit tuaj.
- Për problem të tjera lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë në UPT mund të kontaktoni me Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë: <http://upt.al/cilesia-ne-upt>